

Njoftim për shqyrtimin e çmimeve

Draft njoftim

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë me anë të këtij njoftimi, njofton synimet e veta për të filluar një shqyrtim të kostove dhe të ardhurave vjetore të lejuara të aktiviteteve tregtare individuale të KEK-ut, në përputhje me Metodologjinë e Tarifave të nxjerrë nga Bordi. Plani i zbatimit dhe orari i propozuar për shqyrtimin, mund të gjendet të faqen elektronike të ZRRE-së: www.ero-ks.org

Zyra e Rregullatorit të Energjisë fton çdo palë të interesuar për këtë shqyrtim, që të regjistrohet në ZRRE, ose duke dërguar e-mail në: ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org ose, duke faksuar apo dërguar letër që i adresohet Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve. Palët e regjistruara do të njoftohen kur ZRRE-ja të nxjerrë dokumente përkatës, kur të ketë marrë dorëzimet, ose nëse krijohen mundësitë për pjesëmarrje publike gjatë rrjedhës së shqyrtimit të çmimeve. Regjistrimi do të përfundojë më 31 mars 2006. Lista e palëve të regjistruara dhe detajet për kontaktim, do të botohen në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Njoftimet e përgjithshme mbi mundësitë për të siguruar dorëzim me shkrim të dokumenteve, ose për të marrë pjesë në dëgjime publike do të shpallen po ashtu nga ZRRE-ja në faqen e vet zyrtare, në përputhje me kriteret e Rregullit mbi Parimet e Përlllogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Çdo palë që dëshiron të dorëzojë planin e zbatimit dhe orarin për Shqyrtimin e Çmimit, është i ftuar që të dërgojë në ZRRE sa më sipër, ose duke dërguar e-mail në ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org ose me anë të faksit apo letrës që i adresohen Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve përpara 31 marsit 2006.